<p><b>Qëllimet dhe Objektivat</b></p>	<p>Machine Learning përbën një komponent kyç në zhvillimin e sistemeve moderne financiare dhe në implementimin e zgjidhjeve të bazuara në inteligjencë artificiale në sektorin e financës dhe FinTech. Qëllimi i kësaj lënde është të zhvillojë kompetencat teorike dhe praktike të studentëve në analizën e të dhënave financiare, ndërtimin e modeleve, trajnimin, validimin dhe integrimin e modeleve të Machine Learning në sisteme dhe aplikacione financiare.</p> <p>Lënda synon gjithashtu të forcojë aftësitë analitike, kritike dhe profesionale të studentëve në aplikimin e teknikave të Machine Learning për zgjidhjen e problemeve reale financiare, përfshirë menaxhimin e rrezikut, zbulimin e mashtrimeve, vlerësimin e kredive dhe parashikimin e tregjeve.</p> <p>Objektivat e lëndës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të prezantojë konceptet themelore, paradigmat dhe arkitekturën e sistemeve të Machine Learning në financë.</li> <li>• Të zhvillojë aftësinë për të përzgjedhur dhe implementuar algoritmet kryesore të mësimin të mbikëqyruar dhe të pambikëqyruar për të dhëna financiare.</li> <li>• Të pajisë studentët me aftësi në përgatitjen, pastrimin dhe transformimin e dataset-eve financiare për qëllime modelimi.</li> <li>• Të analizojë dhe interpretojë performancën e modeleve duke përdorur metrika statistikore dhe teknika validimi në kontekst financiar.</li> <li>• Të aplikojë dhe integrojë modele të Machine Learning në aplikacione reale financiare dhe në proceset e vendimmarrjes.</li> </ul>				
<p><b>Rezultatet e pritshme (RP)</b></p>	<p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të shpjegojë dhe dallojë konceptet kyçe, paradigmat dhe algoritmet e Machine Learning në kontekstin e sistemeve dhe aplikacioneve financiare. (PLO4)</li> <li>2. Të përzgjedhë dhe implementojë algoritme të mësimin të mbikëqyruar dhe të pambikëqyruar për të zgjidhur probleme financiare si vlerësimi i kredive, zbulimi i mashtrimeve dhe vlerësimi i rrezikut. (PLO4, PLO5)</li> <li>3. Të përgatisë, pastrojë dhe transformojë dataset-et financiare duke përdorur teknika të përshtatshme të parapërpunimit dhe ndarjes së të dhënave për trajnim dhe testim. (PLO4, PLO5)</li> <li>4. Të analizojë dhe vlerësojë performancën e modeleve të Machine Learning duke përdorur metrika statistikore dhe teknika validimi (p.sh., cross-validation, confusion matrix, precision/recall) në kontekst financiar. (PLO5)</li> <li>5. Të zhvillojë dhe testojë zgjidhje të Machine Learning për aplikacione financiare duke përdorur mjete programimi si Python dhe biblioteka përkatëse (p.sh., scikit-learn, pandas, numpy). (PLO4, PLO5)</li> <li>6. Të vlerësojë implikimet etike, ligjore dhe profesionale të aplikimit të modeleve të Machine Learning në financë, përfshirë çështje si paragjykimi (bias), transparenca dhe privatësia e të dhënave. (PLO6, PLO8)</li> </ol>				
<p><b>Përmbajtja</b></p>	<table border="0"> <tr> <td><b>Plani javor</b></td> <td style="text-align: right;"><b>Java</b></td> </tr> <tr> <td>Hyrje në Machine Learning dhe roli i tij në sistemet financiare dhe FinTech</td> <td style="text-align: right;">1</td> </tr> </table>	<b>Plani javor</b>	<b>Java</b>	Hyrje në Machine Learning dhe roli i tij në sistemet financiare dhe FinTech	1
<b>Plani javor</b>	<b>Java</b>				
Hyrje në Machine Learning dhe roli i tij në sistemet financiare dhe FinTech	1				

	Llojet e mësimit: i mbikëqyrur, i pambikëqyrur dhe përforcues me shembuj financiarë	2
	Përgatitja dhe parapërpunimi i të dhënave financiare (pastrim, normalizim, inxhinieri e veçorive)	3
	Regresioni linear për parashikime financiare (çmimet e aksioneve, vlerësimi i rrezikut)	4
	Regresioni logjistik dhe klasifikimi binar në financë (zbulimi i mashtrimeve, parashikimi i mosshlyerjes)	5
	Pemët e vendimmarrjes dhe Random Forest për vlerësimin e kredive dhe miratimin e huave	6
	Metrikat e vlerësimit të modeleve (Confusion Matrix, Accuracy, Precision, Recall, ROC-AUC)	7
	Klastrimi dhe reduktimi i dimensioneve (K-Means, PCA) për segmentimin e klientëve dhe analizën e portofolit	8
	Bazat e rrjeteve neuronale dhe aplikimet në parashikimin financiar	9
	Overfitting, Underfitting dhe Cross-Validation (përfshirë Walk-Forward për të dhëna kohore)	10
	Integrimi i modeleve të Machine Learning në sistemet financiare dhe aplikacionet FinTech	11
	tika, paragjykimi dhe përgjegjësia profesionale në Machine Learning financiar	12
	Projekt praktik: aplikimi i ML në një rast përdorimi financiar	13
	Rishikim dhe përgatitje për test	14
	Prezantime / konsultime	15
<b>Metodat e mësimdhënies</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Pesha (%)</b>
	Ligjerata	30%
	Ushtrime laboratorike	30%
	Seminar/Projekte	25%
	Raste studimi (case studies)	15%
	Lënda është projektuar të jetë gjithëpërfshirëse dhe e qasshme për të gjithë studentët. Metodat e mësimdhënies, materialet mësimore dhe detyrat e vlerësimit mund të përshtaten, kur është e nevojshme, për të përmbushur nevojat e studentëve me nevoja të veçanta dhe për të siguruar mundësi të barabarta për pjesëmarrje dhe arritje.	
	Mekanizmat mbështetës, përfshirë konsultimet individuale dhe bashkëpunimin me shërbimet mbështetëse për studentët, janë forcuar për të siguruar që studentët të marrin ndihmën e duhur akademike. Praktikrat e mësimdhënies gjithëpërfshirëse do të zbatohen për të rritur qasshmërinë dhe pjesëmarrjen e barabartë në procesin e të nxënës.	
<b>Metodat e vlerësimit</b>	<b>Aktiviteti i vlerësimit</b>	<b>Pesha (%)</b>
	Prezenca dhe aktiviteti në klase	10%
	Projekt Grupor	20%
	Detyra individuale	20%

	Provimi Final	50%
<b>Përshkrimi i Vlerësimit</b>	<p>Pjesëmarrja dhe aktiviteti në klasë (10%) -Pjesëmarrje në ligjërata, diskutime dhe ushtrime praktike mbi aplikimet e Machine Learning në financë. (Adreson RP1, RP6)</p> <p>Projekte grupore (20%) - Projekt bashkëpunues që aplikon teknika të Machine Learning në një problem real financiar (p.sh., vlerësimi i kredive, zbulimi i mashtrimeve, parashikimi i tregjeve). Përfshin raport dhe dorëzim të kodit. (Adreson RP2, RP3, RP4, RP6)</p> <p>Detyra individuale (20%) - Ushtrime praktike mbi parapërpunimin e të dhënave, implementimin e modeleve dhe vlerësimin e tyre duke përdorur dataset-e financiare. (Adreson RP2, RP3, RP4)</p> <p>Provimi final (50%) - Vlerësim gjithëpërfshirës që mbulon teorinë, algoritmet e Machine Learning, aftësitë praktike dhe aspektet etike në ML financiar. (Adreson RP1, RP2, RP4, RP6).</p>	
<b>Kriteret e Vlerësimit</b>	<p>Për të kaluar me sukses lëndën, studentët duhet të arrijnë të paktën 50% të pikëve totale të shpërndara në të gjitha metodat e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrja dhe angazhimi në klasë</li> <li>• Projektin grupor</li> <li>• Detyrat individuale</li> <li>• Provimin final</li> </ul> <p>Pjesëmarrja e rregullt në ligjërata dhe aktivitetet e kursit konsiderohet një pjesë thelbësore e procesit të të nxënit. Studentët pritet të ndjekin ligjëratat sipas orarit të përcaktuar të lëndës.</p>	
<b>Burimet dhe mjetet e konkretizimit</b>	<b>Mjetet</b>	<b>Numri</b>
	Klase (e.g)	1
	Laborator (e.g)	1
	Moodle	1
	Softuer Windows 10, MS Office 2019	1
	Projektor	1
<b>Ngarkesa dhe aktivitetet</b>	<b>Lloji i aktivitetit</b>	<b>Ngarkesa total</b>
	Ligjerata	30
	Seminare	20
	Ushtrime Laboratorike	30
	Mesim i pavarur	67
	Konsultime	3
<b>Literatura/Referencat</b>	<p><b>Literatura primare:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Introduction to Machine Learning, fourth edition, Ethem Alpaydın, ISBN: 9780262043793</li> <li>2. Machine Learning for Dummies, 3rd Edition, Luca Massaron, John Paul Mueller, ISBN: 978-1-394-37323-9</li> </ol>	

	<p>3. Hands-On Machine Learning with Scikit-Learn, Keras, and TensorFlow 2nd edition; Aurélien Géron; ISBN: 978-1-492-03264-9</p> <p>4. Machine Learning with PyTorch python and Scikit-Learn, Sebastian Raschka, Yuxi (Hayden) Liu, Vahid Mirjalili, SBN 978-1-80181-931-2</p> <p><b>Literatura sekondare:</b></p> <p>1. The Hundred-Page Machine Learning Book, Andriy Burkov, SIBN: 978-1999579500</p> <p>2. Pattern Recognition and Machine Learning, Christopher M. Bishop, ISBN-13: 978-0387-31073-2</p> <p>3. Deep Learning. MIT Press. Goodfellow, I., Bengio, Y., Courville, A.</p>
<b>Standardet etike</b>	<p>Të gjithë studentët e kësaj lënde duhet t'u përmbahen standardeve më të larta të integritetit akademik të përcaktuara në Kodin e Etikës të Kolegjit UBT. Kjo përfshin dorëzimin e punës origjinale për detyra, projekte, kuize dhe provime. Aktet e plagjiaturës, mashtrimit dhe përdorimit të punës së një personi tjetër pa citim të duhur janë rreptësisht të ndaluara. Kjo përfshin gjithashtu përdorimin e materialeve të paautorizuara gjatë provimeve, kuizeve ose çdo forme tjetër vlerësimi, si dhe paraqitjen e projekteve në grup me punën e të tjerëve pa mirënjohjen e duhur.</p> <p>Detyrat me shkrim do të kontrollohen duke përdorur programin anti-plagjiaturë Turnitin. Për nivelin Bachelor, indeksi i ngjashmërisë duhet të jetë nën 15%, dhe për nivelin Master, nën 10% (duke përjashtuar referencat, citimet dhe burimet e vogla). Shkeljet si plagjiatura, mashtrimi gjatë provimeve ose kuizeve, ose çdo formë e sjelljes së pandershme akademike do të çojë në ndëshkime, duke përfshirë një notë të dështuar për detyrën ose lëndën, dhe mund të rezultojë në veprime të mëtejshme disiplinore siç përshkruhet nga politikat e Kolegjit UBT. Studentët pritet të ruajnë integritetin në të gjitha aktivitetet akademike dhe të respektojnë pronën intelektuale të të tjerëve. Për më shumë informacion mbi standardet etike dhe pasojat për shkeljet, ju lutemi referojuni Kodit të Etikës së UBT-së, i çashtëm përmes manualit të studentëve ose faqes së internetit të kolegjit.</p>

<b>Lënda</b>	<b>SISTEMET E INFORMACIONIT TË MENAXHIMIT</b>			
	Lloji	Semestri	ECTS	Kodi
	OBLIGATIVE (O)	4	6	10MIS592
<b>Qëllimet dhe Objektivat</b>	<p>Kjo lëndë u ofron studentëve një hyrje në sistemet e informacionit dhe mënyrën se si ato përdoren nga organizatat për të arritur objektivat strategjike dhe operacionale. Ajo prezanton çështje dhe praktika menaxheriale të brendshme dhe të jashtme për menaxhimin e teknologjisë dhe informacionit. Çështjet e brendshme: teknologjia e informacionit, proceset e biznesit, stafi, buxhetimi dhe planifikimi. Çështjet e jashtme: mjediset organizative,</p>			

	<p>politika, marketingu, planifikimi strategjik, burimet e financimit. Studentët duhet të jenë në gjendje të analizojnë nevojat e organizatës për sistemet e informacionit dhe mënyrën se si këto sisteme i përbushin ato nevoja.</p> <p>Objektivat e lëndës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kuptojnë rolin e sistemeve të informacionit në mbështetjen e operacioneve të biznesit dhe vendimmarrjes.</li> <li>• Të analizojnë se si sistemet e informacionit kontribuojnë në efikasitetin organizativ dhe avantazhin konkurrues.</li> <li>• Të eksplorojnë aplikimin e sistemeve të informacionit në teknologjitë financiare (FinTech) dhe mjedise digjitale.</li> <li>• Të vlerësojnë çështjet e sigurisë, etike dhe të rrezikut në përdorimin e sistemeve të informacionit.</li> </ul>																										
<p><b>Rezultatet e pritshme (RP)</b></p>	<p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të identifikojnë nevojat organizative dhe të dhënat financiare dhe mënyrën se si sistemet e informacionit i përbushin këto nevoja në mjedise FinTech. (PLO4)</li> <li>2. Të përcaktojnë se si zgjidhjet teknologjike (p.sh., platformat digjitale, sistemet e pagesave) ndikojnë tek palët e interesit në ekosistemet financiare. (PLO7)</li> <li>3. Të priorizojnë kërkesat dhe kufizimet e sistemeve në kontekstin e shërbimeve financiare dhe platformave digjitale. (PLO7)</li> <li>4. Të vendosin nëse duhet të ndërtojnë apo të blejnë zgjidhje teknologjike dhe të identifikojnë burimet e nevojshme për implementimin e sistemeve të informacionit financiar. (PLO4, PLO7)</li> <li>5. Të ndërtojnë një matricë vendimmarrjeje për të vlerësuar sistemet dhe platformat alternative të teknologjisë financiare. (PLO10)</li> <li>6. Të zhvillojnë një plan implementimi dhe pas-implementimi për sistemet e informacionit në organizatat financiare. (PLO4, PLO6)</li> <li>7. Të krijojnë dokumentacion të përshtatshëm për të justifikuar dhe mbrojtur investimet në teknologji në sistemet financiare para menaxhmentit. (PLO10)</li> </ol>																										
<p><b>Përmbajtja</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="410 1352 1323 1388"><b>Plani javor</b></th> <th data-bbox="1323 1352 1510 1388"><b>Java</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="410 1388 1323 1430">Hyrije në menaxhimin e sistemeve të informacioneve</td> <td data-bbox="1323 1388 1510 1430">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="410 1430 1323 1472">Harduerët dhe Softuerët</td> <td data-bbox="1323 1430 1510 1472">2</td> </tr> <tr> <td data-bbox="410 1472 1323 1514">Tipet e Sistemeve të Informacionit</td> <td data-bbox="1323 1472 1510 1514">3</td> </tr> <tr> <td data-bbox="410 1514 1323 1556">Përkrahja e vendimmarrjes</td> <td data-bbox="1323 1514 1510 1556">4</td> </tr> <tr> <td data-bbox="410 1556 1323 1598">Rrjetat Kompjuterike</td> <td data-bbox="1323 1556 1510 1598">5</td> </tr> <tr> <td data-bbox="410 1598 1323 1640">Databazat - Data Mining dhe Business Intelligence</td> <td data-bbox="1323 1598 1510 1640">6</td> </tr> <tr> <td data-bbox="410 1640 1323 1682">Testi 1</td> <td data-bbox="1323 1640 1510 1682">7</td> </tr> <tr> <td data-bbox="410 1682 1323 1724">Strategjia e TI dhe marrja e shërbimeve të TI</td> <td data-bbox="1323 1682 1510 1724">8</td> </tr> <tr> <td data-bbox="410 1724 1323 1766">Përdorimi i TI si avantazh kompetitiv</td> <td data-bbox="1323 1724 1510 1766">9</td> </tr> <tr> <td data-bbox="410 1766 1323 1808">E-Commerce (Tregtia elektronike)</td> <td data-bbox="1323 1766 1510 1808">10</td> </tr> <tr> <td data-bbox="410 1808 1323 1850">Siguria e Informacionit dhe Çështjet Etike</td> <td data-bbox="1323 1808 1510 1850">11</td> </tr> <tr> <td data-bbox="410 1850 1323 1892">Prezantimi i punimeve</td> <td data-bbox="1323 1850 1510 1892">12</td> </tr> </tbody> </table>	<b>Plani javor</b>	<b>Java</b>	Hyrije në menaxhimin e sistemeve të informacioneve	1	Harduerët dhe Softuerët	2	Tipet e Sistemeve të Informacionit	3	Përkrahja e vendimmarrjes	4	Rrjetat Kompjuterike	5	Databazat - Data Mining dhe Business Intelligence	6	Testi 1	7	Strategjia e TI dhe marrja e shërbimeve të TI	8	Përdorimi i TI si avantazh kompetitiv	9	E-Commerce (Tregtia elektronike)	10	Siguria e Informacionit dhe Çështjet Etike	11	Prezantimi i punimeve	12
<b>Plani javor</b>	<b>Java</b>																										
Hyrije në menaxhimin e sistemeve të informacioneve	1																										
Harduerët dhe Softuerët	2																										
Tipet e Sistemeve të Informacionit	3																										
Përkrahja e vendimmarrjes	4																										
Rrjetat Kompjuterike	5																										
Databazat - Data Mining dhe Business Intelligence	6																										
Testi 1	7																										
Strategjia e TI dhe marrja e shërbimeve të TI	8																										
Përdorimi i TI si avantazh kompetitiv	9																										
E-Commerce (Tregtia elektronike)	10																										
Siguria e Informacionit dhe Çështjet Etike	11																										
Prezantimi i punimeve	12																										

	Firma Dixhitale (ERP Modulet I)	13
	Firma Dixhitale (ERP Modulet II)	14
	Testi 2	15
<b>Metodat e mësimdhënies</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Pesha (%)</b>
	Ligjerata	50%
	Projekt	10%
	Raste studimi (case studies)	10%
	Laborator (SAP S/4HANA)	20%
	Flipped classroom	10%
	<p>Lënda është projektuar të jetë gjithëpërfshirëse dhe e qasshme për të gjithë studentët. Metodatat e mësimdhënies, materialet mësimore dhe detyrat e vlerësimit mund të përshtaten, kur është e nevojshme, për të përmbushur nevojat e studentëve me nevoja të veçanta dhe për të siguruar mundësi të barabarta për pjesëmarrje dhe arritje.</p> <p>Mekanizmat mbështetës, përfshirë konsultimet individuale dhe bashkëpunimin me shërbimet mbështetëse për studentët, janë forcuar për të siguruar që studentët të marrin ndihmën e duhur akademike. Praktikatat e mësimdhënies gjithëpërfshirëse do të zbatohen për të rritur qasshmërinë dhe pjesëmarrjen e barabartë në procesin e të nxënës.</p>	
<b>Metodat e vlerësimit</b>	<b>Aktiviteti i vlerësimit</b>	<b>Pesha (%)</b>
	Aktiviteti në klase	20%
	Projektet	30%
	Provimi ndërmjetës I dhe II, ose Provimi Final	50%
<b>Përshkrimi i Vlerësimit</b>	<p>Aktiviteti i klasës (20%) - vlerëson angazhimin përmes diskutimeve dhe ideve novatore në ushtrime dhe ligjërata, duke përfshirë pjesëmarrjen aktive në ligjërata dhe ushtrime, shfaqjen e mendimit kritik gjatë diskutimeve të rasteve studimore, dhe realizimin e moduleve ERP në një platformë reale ERP. (Adreson RP1 - RP6)</p>	
	<p>Projekti (30%) - përfshin punë grupore prej 3 deri në 5 studentë. Përmes këtij projekti, studentët analizojnë një ndërmarrje relevante dhe, bazuar në objektivat e paraqitura nga ndërmarrjet, propozojnë gjithashtu sistemet përkatëse. Projekti ka një volum prej 2500 deri në 3000 fjalë. (Adreson: RP1 - RP6)</p>	
	<p>Provimi Final (50%) - instrument vlerësimi që aplikohet pas përfundimit të ligjëratave. Provimi përmban 15 deri në 20 pyetje dhe zgjat 90 minuta. Pyetjet e provimit mbulojnë tërësisht materialin e përvetësuar gjatë semestrit dhe janë në përputhje me rezultatet e të mësuarit të kursit. (Adreson RP1 - RP7)</p>	

<b>Kriteret e Vlerësimit</b>	<p>Për të kaluar me sukses lëndën, studentët duhet të arrijnë të paktën 50% të pikëve totale të shpërndara në të gjitha metodat e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktiviteti në klasë</li> <li>• Projektin</li> <li>• Provimi ndërmjetës I dhe II, ose Provimi Final</li> </ul> <p>Pjesëmarrja e rregullt në ligjërata dhe aktivitetet e kursit konsiderohet një pjesë thelbësore e procesit të të nxënit. Studentët pritet të ndjekin ligjëratat sipas orarit të përcaktuar të lëndës.</p>												
<b>Burimet dhe mjetet e konkretizimit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Mjetet</th> <th>Numri</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Klase (e.g)</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Laborator (e.g)</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Moodle</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Projektor</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table>	Mjetet	Numri	Klase (e.g)	1	Laborator (e.g)	1	Moodle	1	Projektor	1		
Mjetet	Numri												
Klase (e.g)	1												
Laborator (e.g)	1												
Moodle	1												
Projektor	1												
<b>Ngarkesa dhe aktivitetet</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Lloji i aktivitetit</th> <th>Ngarkesa total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Ligjerata</td> <td>26</td> </tr> <tr> <td>Projekt</td> <td>25</td> </tr> <tr> <td>Provimi ndërmjetës I dhe II</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Mesim i pavarur</td> <td>94</td> </tr> <tr> <td>Prezentim</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table>	Lloji i aktivitetit	Ngarkesa total	Ligjerata	26	Projekt	25	Provimi ndërmjetës I dhe II	4	Mesim i pavarur	94	Prezentim	1
Lloji i aktivitetit	Ngarkesa total												
Ligjerata	26												
Projekt	25												
Provimi ndërmjetës I dhe II	4												
Mesim i pavarur	94												
Prezentim	1												
<b>Literatura/Referencat</b>	<p><b>Literatura primare :</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Management information systems, Kenneth C. Laudon, Jane P. Laudon</li> <li>2. Kozeta Sevrani-Sistemet e Informacionit te Menaxhimit-Tirane</li> <li>3. Gerald V. Post, Management Information Systems: Solving Business Problems with Information Technology. Seventh Edition</li> <li>4. Bird, M. (2010).” Modern Management Guide to Information Technology”. Boston: Irwin McGraw-Hill.</li> <li>5. Skeja, A. (2024). Integrimi i strategjive menaxheriale dhe sistemeve të informacionit për përmirësimin e efikasitetit në epokën dixhitale: Menaxhimi i dembelisë kibernetike (cyberloafing). Prishtinë: Shtëpia botuese Lena</li> </ol> <p><b>Literatura sekondare:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sousa K. J., Oz E., (2014), “Management Information Systems”, Cengage Learning, 7th Edition</li> <li>2. Biswas J., (2020), Management Information Systems, SAGE Publications, 1st Edition</li> </ol>												
<b>Standardet etike</b>	<p>Të gjithë studentët e kësaj lënde duhet t'u përmbahen standardeve më të larta të integritetit akademik të përcaktuara në Kodin e Etikës të Kolegjit UBT. Kjo përfshin dorëzimin e punës origjinale për detyra, projekte, kuize dhe provime. Aktet e plagjiaturës, mashtrimit dhe përdorimit të punës së një personi tjetër pa citim të duhur janë rreptësisht të ndaluara. Kjo përfshin gjithashtu përdorimin e materialeve të paautorizuara gjatë provimeve, kuizeve ose</p>												

	<p>çdo forme tjetër vlerësimi, si dhe paraqitjen e projekteve në grup me punën e të tjerëve pa mirënjohjen e duhur.</p> <p>Detyrat me shkrim do të kontrollohen duke përdorur programin anti-plagjiaturë Turnitin. Për nivelin Bachelor, indeksi i ngjashmërisë duhet të jetë nën 15%, dhe për nivelin Master, nën 10% (duke përfshirë referencat, citimet dhe burimet e vogla). Shkeljet si plagjiatura, mashtrimi gjatë provimeve ose kuizeve, ose çdo formë e sjelljes së pandershme akademike do të çojë në ndëshkime, duke përfshirë një notë të dështuar për detyrën ose lëndën, dhe mund të rezultojë në veprime të mëtejshme disiplinore siç përshkruhet nga politikat e Kolegjit UBT. Studentët pritet të ruajnë integritetin në të gjitha aktivitetet akademike dhe të respektojnë pronën intelektuale të të tjerëve. Për më shumë informacion mbi standardet etike dhe pasojat për shkeljet, ju lutemi referojuni Kodit të Etikës së UBT-së, i çashëm përmes manualit të studentëve ose faqes së internetit të kolegjit.</p>
--	---

<b>Lënda</b>	<b>MENAXHIMI I RREZIKUT DHE SIGURIME</b>			
	Lloji	Semestri	ECTS	Kodi
	OBLIGATIVE (O)	4	6	10RMI593
<b>Qëllimet dhe Objektivat</b>	<p>Kjo lëndë synon të ofrojë një kuptim të thelluar të menaxhimit të rrezikut dhe industrisë së sigurimeve, duke u fokusuar në strukturën, funksionet dhe rolin e saj në ekonominë moderne. Ajo trajton mënyrën se si identifikohen, analizohen dhe menaxhohen rreziqet, si dhe rëndësinë e sigurimeve si mekanizëm për transferimin e tyre. Lënda përfshin sigurimet jetësore dhe jo-jetësore, dizajnimin e produkteve, përcaktimin e çmimeve dhe menaxhimin e dëmeve. Theksi vendoset në aplikimin praktik të koncepteve përmes analizës së rasteve reale dhe përdorimit të teknikave të ndryshme të menaxhimit të rrezikut. Në këtë mënyrë, studentët zhvillojnë aftësi analitike dhe vendimmarrëse, duke u përgatitur për sfidat profesionale dhe mundësitë e karrierës në sektorin e sigurimeve dhe menaxhimit të rrezikut.</p> <p>Objektivat kryesore të kësaj lënde janë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të zhvillohet një kuptim i qartë i rreziqeve të sigurimeve dhe klasifikimit të tyre në sigurimet jetësore dhe jo-jetësore.</li> <li>• Të shpjegohen instrumentet kryesore të menaxhimit të rrezikut, përfshirë çmimin, solvencën, rezervat dhe risigurimin.</li> </ul>			

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kuptohet struktura dhe përbërësit e kontratave të sigurimit dhe llojet e ndryshme të produkteve të sigurimit.</li> <li>• Të aplikohen proceset e menaxhimit të rrezikut si identifikimi, matja dhe kontrolli në situata praktike.</li> <li>• Të zhvillohen aftësi praktike për analizimin e rasteve reale në sigurime dhe menaxhim të rrezikut duke përdorur mjete dhe teknika të përshtatshme.</li> </ul>																		
<b>Rezultatet e pritshme (RP)</b>	<p>Në përfundim të kësaj lënde, studentët duhet të kenë aftësitë të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikojnë dhe klasifikojnë rreziqet e sigurimeve në sigurimet jetësore dhe jo-jetësore (PLO5).</li> <li>2. Të shpjegojnë dhe interpretojnë instrumentet kryesore të menaxhimit të rrezikut, përfshirë llogaritjen e primit dhe normës, solvencën, rezervat teknike, risigurimin dhe matjen e performancës së rregulluar për rrezik (PLO5).</li> <li>3. Të përshkruajnë dhe dallojnë kontratat dhe dispozitat e sigurimit, si dhe karakteristikat e sigurimeve të pasurisë, motorike, të përgjegjësisë dhe personale (PLO8).</li> <li>4. Të aplikojnë proceset e menaxhimit të rrezikut, duke përfshirë identifikimin, matjen dhe kontrollin e rrezikut në situata praktike (PLO5).</li> <li>5. Të përdorin mjete dhe teknika të përshtatshme për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të projekteve (PLO5).</li> <li>6. Të demonstrojnë aftësi praktike në sigurime dhe menaxhim të rrezikut përmes analizës së rasteve reale dhe shembujve të aplikuar (PLO5, PLO6).</li> <li>7. Analizon rolin e teknologjive digjitale, përfshirë InsurTech dhe zgjidhjet e bazuara në blockchain, në transformimin e menaxhimit të rrezikut dhe praktikave të sigurimeve. (PLO3, PLO7)</li> </ol>																		
<b>Përmbajtja</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="415 1413 1328 1451"><b>Plani javor</b></th> <th data-bbox="1328 1413 1516 1451"><b>Java</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="415 1451 1328 1491">Rreziku nga perspektiva e sigurimeve</td> <td data-bbox="1328 1451 1516 1491">1</td> </tr> <tr> <td data-bbox="415 1491 1328 1530">Bazat e menaxhimit të rrezikut</td> <td data-bbox="1328 1491 1516 1530">2</td> </tr> <tr> <td data-bbox="415 1530 1328 1570">Aktivitetet kryesore të sigurimeve</td> <td data-bbox="1328 1530 1516 1570">3</td> </tr> <tr> <td data-bbox="415 1570 1328 1610">Operacionet e kompanive të sigurimit</td> <td data-bbox="1328 1570 1516 1610">4</td> </tr> <tr> <td data-bbox="415 1610 1328 1650">Sigurimet motorike: Auto përgjegjësia dhe Kasko</td> <td data-bbox="1328 1610 1516 1650">5</td> </tr> <tr> <td data-bbox="415 1650 1328 1690">Përfitimet e punonjësve: Sigurimi shëndetësor</td> <td data-bbox="1328 1650 1516 1690">6</td> </tr> <tr> <td data-bbox="415 1690 1328 1730">Kollokfiumi I</td> <td data-bbox="1328 1690 1516 1730">7</td> </tr> <tr> <td data-bbox="415 1730 1328 1862">Parimet dhe produktet e sigurimeve të jetës</td> <td data-bbox="1328 1730 1516 1862">8</td> </tr> </tbody> </table>	<b>Plani javor</b>	<b>Java</b>	Rreziku nga perspektiva e sigurimeve	1	Bazat e menaxhimit të rrezikut	2	Aktivitetet kryesore të sigurimeve	3	Operacionet e kompanive të sigurimit	4	Sigurimet motorike: Auto përgjegjësia dhe Kasko	5	Përfitimet e punonjësve: Sigurimi shëndetësor	6	Kollokfiumi I	7	Parimet dhe produktet e sigurimeve të jetës	8
<b>Plani javor</b>	<b>Java</b>																		
Rreziku nga perspektiva e sigurimeve	1																		
Bazat e menaxhimit të rrezikut	2																		
Aktivitetet kryesore të sigurimeve	3																		
Operacionet e kompanive të sigurimit	4																		
Sigurimet motorike: Auto përgjegjësia dhe Kasko	5																		
Përfitimet e punonjësve: Sigurimi shëndetësor	6																		
Kollokfiumi I	7																		
Parimet dhe produktet e sigurimeve të jetës	8																		

	Sigurimi i përgjegjësive komerciale	9
	Rreziku i përgjegjësish dhe menaxhimi i tij	10
	Sigurimi kundër krimit dhe garancitë	11
	Sigurimi i pronës	12
	Anuitetet dhe llogaritë individuale	13
	Prezantimet e studentëve	14
	Kollokfiumi II	15
<b>Metodat e mësimdhënies</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Pesha (%)</b>
	Ligjerata	30%
	Seminare	10%
	Raste studimi (case studies)	20%
	Simulim i roleve (role play)	20%
	Zgjidhje te problemeve (problem-based learning)	20%
	<p>Lënda është projektuar të jetë gjithëpërfshirëse dhe e qasshme për të gjithë studentët. Metodat e mësimdhënies, materialet mësimore dhe detyrat e vlerësimit mund të përshtaten, kur është e nevojshme, për të përmbushur nevojat e studentëve me nevoja të veçanta dhe për të siguruar mundësi të barabarta për pjesëmarrje dhe arritje.</p> <p>Mekanizmat mbështetës, përfshirë konsultimet individuale dhe bashkëpunimin me shërbimet mbështetëse për studentët, janë forcuar për të siguruar që studentët të marrin ndihmën e duhur akademike. Praktikrat e mësimdhënies gjithëpërfshirëse do të zbatohen për të rritur qasshmërinë dhe pjesëmarrjen e barabartë në procesin e të nxënës.</p>	
<b>Metodat e vlerësimit</b>	<b>Aktiviteti i vlerësimit</b>	<b>Pesha (%)</b>
	Prezenca dhe aktiviteti ne klase	10%
	Testi I	35%
	Testi II	35%
	Prezantimi Verbal	20%
<b>Përshkrimi i Vlerësimit</b>	Prezenca dhe aktiviteti ne klase (10%) - Ky komponent vlerëson pjesëmarrjen aktive të studentëve, angazhimin dhe përfshirjen e vazhdueshme gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve praktike. Vlerësimi bazohet në konsistencën, kontributin në diskutime, mendimin kritik dhe aftësinë për të demonstruar kuptimin e koncepteve kryesore gjatë gjithë semestrit. Përmes	

	<p>detyrave të shkurtra, ushtrimeve dhe diskutimeve, nxitet të nxënit aktiv dhe bashkëpunimi. Ky komponent mbulon dhe adreson të gjitha rezultatet e të nxënit (Adreson RP1- RP6).</p> <p><b>Testi I &amp; Testi II</b> (35% + 35%) - Këto janë vlerësime me shkrim që matin nivelin e kuptimit dhe aftësitë analitike të studentëve në dy faza të kursit. Provimi i parë zhvillohet në javën e 7-të dhe përfshin materialin nga javët 1-6. Provimi i dytë mbahet në javën e 15-të dhe përfshin materialin nga javët 8-13. Secili provim përmban 5-8 pyetje eseistike që vlerësojnë mendimin kritik dhe aplikimin e njohurive teorike në situata praktike. (Adreson RP1, RP3, RP4, RP6)</p> <p><b>Prezantimi verbal</b> (20%) - Studentët, individualisht ose në çifte, do të prezantojnë një temë të caktuar nga ligjëruesi. Vlerësimi bazohet në cilësinë e hulumtimit, thellësinë e analizës, qartësinë e prezantimit, aspektin vizual dhe aftësinë për t’iu përgjigjur pyetjeve. Rezultatet e pritshme që adresohen varen nga tema e zgjedhur, por zakonisht përfshijnë si nivelin e kuptimit ashtu edhe atë të aplikimit.</p>								
<p><b>Kriteret e Vlerësimit</b></p>	<p>Për të kaluar me sukses lëndën, studentët duhet të arrijnë të paktën 50% të pikëve totale të shpërndara në të gjitha metodat e vlerësimit dhe atë nga aktivitetet më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrja dhe angazhimi në klasë</li> <li>• Testi I</li> <li>• Testi II</li> <li>• Prezantimi Verbal</li> </ul> <p>Pjesëmarrja e rregullt në ligjërata dhe në aktivitetet mësimore konsiderohet thelbësore për përvetësimin e përmbajtjes së lëndës dhe zhvillimin e aftësive analitike. Studentët pritet të ndjekin ligjëratat sipas orarit të përcaktuar, të kontribuojnë në diskutime dhe ushtrime, si dhe të tregojnë përkushtim të vazhdueshëm në procesin e të nxënit.</p>								
<p><b>Burimet dhe mjetet e konkretizimit</b></p>	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="text-align: left;">Mjetet</th> <th style="text-align: right;">Numri</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Klase (e.g)</td> <td style="text-align: right;">1</td> </tr> <tr> <td>Moodle</td> <td style="text-align: right;">1</td> </tr> <tr> <td>Projektor</td> <td style="text-align: right;">1</td> </tr> </tbody> </table>	Mjetet	Numri	Klase (e.g)	1	Moodle	1	Projektor	1
Mjetet	Numri								
Klase (e.g)	1								
Moodle	1								
Projektor	1								
<p><b>Ngarkesa dhe aktivitetet</b></p>	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="text-align: left;">Lloji i aktivitetit</th> <th style="text-align: right;">Ngarkesa total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Ligjerata</td> <td style="text-align: right;">30</td> </tr> <tr> <td>Raste Studimi</td> <td style="text-align: right;">24</td> </tr> <tr> <td>Provime afatmesme/Teste</td> <td style="text-align: right;">2</td> </tr> </tbody> </table>	Lloji i aktivitetit	Ngarkesa total	Ligjerata	30	Raste Studimi	24	Provime afatmesme/Teste	2
Lloji i aktivitetit	Ngarkesa total								
Ligjerata	30								
Raste Studimi	24								
Provime afatmesme/Teste	2								

	<p>Prezantime 2</p> <p>Mesim i pavarur 80</p> <p>Konsultime 12</p>
<b>Literatura/Referencat</b>	<p><b>Literatura Primare:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rejda, G. E., McNamara, M. J. &amp; Rabel, W.H. (2020). <i>Principles of Risk Management and Insurance</i> 14th Edition, Pearson.</li> <li>2. Wagner, J. and Fuino, M. (2024). <i>Risk Management &amp; Introduction to Insurance</i> 1st Edition, EPFL Press.</li> </ol> <p><b>Literatura Sekondare:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Dhuci, O. (2011). Njohuritë bazë për Riskun dhe Drejtimin e tij, Tiranë</li> <li>2. Gashi, Sh. (2011). Analiza e Tregut të sigurimeve, Instituti i Statistikës, Prishtinë</li> <li>3. Ligjeratat e autorizuara nga ligjëruesi, të vendosura në Moodle</li> </ol>
<b>Standardet etike</b>	<p>Të gjithë studentët e kësaj lënde duhet t'u përmbahen standardeve më të larta të integritetit akademik të përcaktuara në Kodin e Etikës të Kolegjit UBT. Kjo përfshin dorëzimin e punës origjinale për detyra, projekte, kuize dhe provime. Aktet e plagjiaturës, mashtrimit dhe përdorimit të punës së një personi tjetër pa citim të duhur janë rreptësisht të ndaluara. Kjo përfshin gjithashtu përdorimin e materialeve të paautorizuara gjatë provimeve, kuizeve ose çdo forme tjetër vlerësimi, si dhe paraqitjen e projekteve në grup me punën e të tjerëve pa mirënjohjen e duhur.</p> <p>Detyrat me shkrim do të kontrollohen duke përdorur programin anti-plagjiaturë Turnitin. Për nivelin Bachelor, indeksi i ngjashmërisë duhet të jetë nën 15%, dhe për nivelin Master, nën 10% (duke përjashtuar referencat, citimet dhe burimet e vogla). Shkeljet si plagjiatura, mashtrimi gjatë provimeve ose kuizeve, ose çdo formë e sjelljes së pandershme akademike do të çojë në ndëshkime, duke përfshirë një notë të dështuar për detyrën ose lëndën, dhe mund të rezultojë në veprime të mëtejshme disiplinore siç përshkruhet nga politikat e Kolegjit UBT. Studentët pritet të ruajnë integritetin në të gjitha aktivitetet akademike dhe të respektojnë pronën intelektuale të të tjerëve. Për më shumë informacion mbi standardet etike dhe pasojat për shkeljet, ju lutemi referojuni Kodit të Etikës së UBT-së, i çashëm përmes manualit të studentëve ose faqes së internetit të kolegjit.</p>

<b>Lënda</b>	<b>INOVACIONI NË SHËRBIMET FINANCIARE</b>			
	Lloji	Semestri	ECTS	Kodi
	OBLIGATIVE (O)	4	6	10IFS594
<b>Qëllimet dhe Objektivat</b>	<p>Kjo lëndë i prezanton studentët me konceptet themelore, modelet e biznesit, dhe dimensionet praktike dhe rregullatore të inovacionit në shërbimet financiare. Ajo shqyrton se si teknologjitë digjitale po transformojnë mënyrën se si institucionet financiare dizajnojnë, ofrojnë dhe menaxhojnë produktet dhe shërbimet financiare. Lënda mbulon bazat e fintech, inovacionin në pagesa, huadhënie digjitale, sigurime digjitale dhe shërbime investimi, open banking, identitetin digjital, blockchain, inteligjencën artificiale, regtech, sigurinë kibernetike, mbrojtjen e konsumatorit dhe çështjet etike, ligjore dhe rregullatore të lidhura me inovacionin financiar. E dizajnuar për studentë të nivelit bachelor, lënda zhvillon një kuptim themelor dhe të aplikuar se si inovacioni po ndikon institucionet financiare, klientët, tregjet dhe kornizat rregullatore.</p> <p>Objektivat e Lëndës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Prezantimi i koncepteve kryesore dhe tendencave në zhvillim në inovacionin e shërbimeve financiare.</li> <li>• Analizimi i mënyrës se si teknologjitë digjitale dhe platformat e reja po transformojnë produktet dhe shërbimet financiare, përfshirë pagesat, huadhënien, investimet dhe sigurimet.</li> <li>• Njohja e studentëve me ekosistemin e inovacionit financiar, duke përfshirë start-up-et fintech, platformat digjitale, institucionet tradicionale dhe rregullatorët.</li> <li>• Zhvillimi i aftësisë së studentëve për të aplikuar konceptet e inovacionit në raste praktike dhe situata reale.</li> <li>• Rritja e vetëdijes për sfidat etike, ligjore, rregullatore, të sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së konsumatorit në inovacionin financiar.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e pritshme (RP)</b>	<p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lende, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikojnë dhe shpjegojnë tendencat kryesore dhe aktorët kryesorë në inovacionin e shërbimeve financiare. (PLO7)</li> </ol>			

	<ol style="list-style-type: none"> <li>2. Analizojnë ndikimin e teknologjive digjitale në pagesa, huadhënie, investime dhe sigurime. (PLO7)</li> <li>3. Vlerësojnë rolin e të dhënave, platformave digjitale dhe teknologjive emergjente në mbështetje të inovacionit financiar. (PLO7)</li> <li>4. Dallojnë çështjet kryesore etike, ligjore, rregullatore, të sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së konsumatorit të lidhura me produktet dhe shërbimet financiare inovative. (PLO8, PLO6)</li> <li>5. Aplikojnë konceptet e lëndës në raste praktike që përfshijnë start-up-et fintech, produktet digjitale dhe modelet e biznesit inovative. (PLO7, PLO8)</li> <li>6. Komunikojnë dhe prezantojnë në mënyrë efektive informacion dhe analiza të lidhura me inovacionin financiar. (PLO9)</li> </ol>																				
<b>Përmbajtja</b>	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="text-align: left;"><b>Plani javor</b></th> <th style="text-align: right;"><b>Java</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Hyrje në inovacionin në shërbimet financiare: konceptet, fushëveprimi, evolucioni dhe nxitësit kryesorë</td> <td style="text-align: right;">1</td> </tr> <tr> <td>Ekosistemi i shërbimeve financiare: bankat, institucionet financiare jobankare, firmat fintech, BigTech dhe platformat dixhitale</td> <td style="text-align: right;">2</td> </tr> <tr> <td>Pagesat dixhitale: pagesat mobile, portofolet elektronike, pagesat QR, pagesat e menjëhershme dhe Bli Tani, Paguaj Më Later (BNPL)</td> <td style="text-align: right;">3</td> </tr> <tr> <td>Huadhënie dixhitale dhe financim alternativ: Huadhënie P2P, financim kolektiv, vlerësim krediti dhe huadhënie e bazuar në platforma</td> <td style="text-align: right;">4</td> </tr> <tr> <td>Insurtech dhe wealthtech: inovacion në sigurime, platforma investimi dhe shërbime këshillimore robotike</td> <td style="text-align: right;">5</td> </tr> <tr> <td>Zhblokimi i inovacionit në financa përmes integritit të API-ve, bankingut të hapur dhe rrjedhës së pandërprerë të të dhënave</td> <td style="text-align: right;">6</td> </tr> <tr> <td>Testi 1</td> <td style="text-align: right;">7</td> </tr> <tr> <td>Blockchain dhe asetet dixhitale: bazat e blockchain, tokenizimi, kripto-asetet, stablecoin-et dhe CBDC-të</td> <td style="text-align: right;">8</td> </tr> <tr> <td>Inteligjenca artificiale në financë: zbulimi i mashtrimeve, automatizimi, analiza e klientëve dhe vlerësimi i kreditit</td> <td style="text-align: right;">9</td> </tr> </tbody> </table>	<b>Plani javor</b>	<b>Java</b>	Hyrje në inovacionin në shërbimet financiare: konceptet, fushëveprimi, evolucioni dhe nxitësit kryesorë	1	Ekosistemi i shërbimeve financiare: bankat, institucionet financiare jobankare, firmat fintech, BigTech dhe platformat dixhitale	2	Pagesat dixhitale: pagesat mobile, portofolet elektronike, pagesat QR, pagesat e menjëhershme dhe Bli Tani, Paguaj Më Later (BNPL)	3	Huadhënie dixhitale dhe financim alternativ: Huadhënie P2P, financim kolektiv, vlerësim krediti dhe huadhënie e bazuar në platforma	4	Insurtech dhe wealthtech: inovacion në sigurime, platforma investimi dhe shërbime këshillimore robotike	5	Zhblokimi i inovacionit në financa përmes integritit të API-ve, bankingut të hapur dhe rrjedhës së pandërprerë të të dhënave	6	Testi 1	7	Blockchain dhe asetet dixhitale: bazat e blockchain, tokenizimi, kripto-asetet, stablecoin-et dhe CBDC-të	8	Inteligjenca artificiale në financë: zbulimi i mashtrimeve, automatizimi, analiza e klientëve dhe vlerësimi i kreditit	9
<b>Plani javor</b>	<b>Java</b>																				
Hyrje në inovacionin në shërbimet financiare: konceptet, fushëveprimi, evolucioni dhe nxitësit kryesorë	1																				
Ekosistemi i shërbimeve financiare: bankat, institucionet financiare jobankare, firmat fintech, BigTech dhe platformat dixhitale	2																				
Pagesat dixhitale: pagesat mobile, portofolet elektronike, pagesat QR, pagesat e menjëhershme dhe Bli Tani, Paguaj Më Later (BNPL)	3																				
Huadhënie dixhitale dhe financim alternativ: Huadhënie P2P, financim kolektiv, vlerësim krediti dhe huadhënie e bazuar në platforma	4																				
Insurtech dhe wealthtech: inovacion në sigurime, platforma investimi dhe shërbime këshillimore robotike	5																				
Zhblokimi i inovacionit në financa përmes integritit të API-ve, bankingut të hapur dhe rrjedhës së pandërprerë të të dhënave	6																				
Testi 1	7																				
Blockchain dhe asetet dixhitale: bazat e blockchain, tokenizimi, kripto-asetet, stablecoin-et dhe CBDC-të	8																				
Inteligjenca artificiale në financë: zbulimi i mashtrimeve, automatizimi, analiza e klientëve dhe vlerësimi i kreditit	9																				

	Regtech, AML/KYC dhe identiteti dixhital në shërbimet financiare	10
	Siguria financiare digjitale, privatësia dhe mbrojtja e klientëve	11
	Etika, rregullimi dhe qeverisja e inovacionit financiar	12
	Përfshirja financiare dhe inovacioni në tregjet në zhvillim	13
	Përmbledhje e lëndës / prezantimeve të studentëve / rishikimit të lëndës	14
	Testi 2	15
<b>Metodat e mësimdhënies</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Pesha (%)</b>
	Ligjerata	30%
	Seminare	15%
	Laboratori	15%
	Studime rastesh	20%
	Lojë me role	5%
	Mësim i bazuar në probleme	15%
	<p>Lënda është hartuar për të qenë gjithëpërfshirës dhe i arritshëm për të gjithë studentët. Metodat e mësimdhënies, materialet mësimore dhe detyrat e vlerësimit mund të përshtaten, kur është e nevojshme, për t'iu përshtatur studentëve me nevoja të veçanta dhe për të siguruar mundësi të barabarta për pjesëmarrje dhe arritje.</p> <p>Mekanizmat mbështetës, duke përfshirë konsultimet individuale dhe bashkëpunimin me shërbimet e mbështetjes së studentëve, janë forcuar për të siguruar që studentët të marrin ndihmën e duhur akademike. Ndërgjegjësimi për praktikën gjithëpërfshirëse të mësimdhënies do të zbatohet për të rritur aksesin dhe pjesëmarrjen e barabartë në procesin e të nxënies.</p>	
<b>Metodat e vlerësimit</b>	<b>Aktiviteti i Vlerësimit</b>	<b>Pesha (%)</b>
	Pjesëmarrja dhe aktiviteti në klasë	10%
	Provimi afatmesëm	25%
	Projekt në grup / studim rasti	30%
	Provimi përfundimtar	35%

<p><b>Përshkrimi i Vlerësimit</b></p>	<p>Pjesëmarrja dhe aktiviteti në klasë (10%) - Vlerëson pjesëmarrjen aktive në ligjërrata, diskutime dhe ushtrime, duke nxitur shpjegimin e koncepteve dhe angazhimin në mini-studi rastesh. (Adreson RP1, RP2, RP4)</p> <p>Provimi i gjysmës së semestrit (25%) - Mbulon temat bazë: inovacioni financiar, ekosistemi fintech, pagesa digjitale, huadhënie, investime dhe insurtech. Përfshin pyetje të shkurtra, konceptuale dhe mini-studi rastesh. (Adreson RP1, RP2, RP3)</p> <p>Projekt grupor / studim rasti (30%) - Studentët analizojnë një produkt, shërbim ose platformë fintech duke aplikuar konceptet e kursit për të vlerësuar inovacionin, teknologjinë, modelin e biznesit dhe aspektet rregullatore/etike. Prezantohet me shkrim dhe/ose gojarisht. (RP3, RP5, RP6)</p> <p>Provimi përfundimtar (35%) - Vlerësim gjithëpërfshirës i të gjitha temave, duke integruar inovacionin, teknologjinë, etikën dhe konsideratat rregullatore. Mund të përfshijë mini-studi rastesh dhe analiza strukturore. (Adreson RP1-RP6)</p>												
<p><b>Kriteret e Vlerësimit</b></p>	<p>Për ta kaluar lenden, studentët duhet të marrin të paktën 50% të pikëve totale të disponueshme në të gjitha komponentët e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrja dhe aktiviteti në klasë</li> <li>• Provimi i gjysmës së semestrit</li> <li>• Projekt grupor / studim rasti</li> <li>• Projekt në grup ose studim rasti</li> <li>• Provimi përfundimtar</li> </ul> <p>Pjesëmarrja e vazhdueshme në leksione dhe aktivitetet e lendes është thelbësore për të nxënësit efektiv. Studentët priten të ndjekin leksionet sipas orarit të publikuar të lendes.</p>												
<p><b>Burimet dhe mjetet e koncretizimit</b></p>	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="text-align: left;"><b>Burimet</b></th> <th style="text-align: right;"><b>Numër</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Klasë</td> <td style="text-align: right;">1</td> </tr> <tr> <td>Laboratori i IT-së</td> <td style="text-align: right;">1</td> </tr> <tr> <td>Platforma Moodle</td> <td style="text-align: right;">1</td> </tr> <tr> <td>Bazat e të dhënave financiare / Materialet e rasteve të pagesave dixhitale</td> <td style="text-align: right;">1</td> </tr> <tr> <td>Mjetet e Simulimit FinTech</td> <td style="text-align: right;">1</td> </tr> </tbody> </table>	<b>Burimet</b>	<b>Numër</b>	Klasë	1	Laboratori i IT-së	1	Platforma Moodle	1	Bazat e të dhënave financiare / Materialet e rasteve të pagesave dixhitale	1	Mjetet e Simulimit FinTech	1
<b>Burimet</b>	<b>Numër</b>												
Klasë	1												
